



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE**  
**PËR ARSIMIN E ORIENTUAR**  
**(ARTISTIK DHE SPORTIV)**  
**DHE ARSIMIN PROFESIONAL**

**LËNDËT:**  
**“GJUHË SHQIPE”**  
**DHE**  
**“LETËRSI”**

**VITI SHKOLLOR 2024 – 2025**  
**KOORDINATORE: ERIDA KOLECI**

## PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	3
2	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT ORIENTUES .....	5
3	PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE GJUHËSORE DHE LETRARE .....	6
3.1	Gjuhë shqipe.....	6
3.2	Letërsi.....	7
4	PESHA E GJUHËS SHQIPE DHE E LETËRSISË NË TEST .....	9
5	STRUKTURA E TESTIT .....	10
6	LLOJET E PYETJEVE/ KËRKESAVE TË REKOMANDUARA .....	11
7	NJOHURITË DHE AFTËSITË SIPAS KOMPETENCAVE .....	12

## 1 HYRJE

Gjuha shqipe dhe letërsia është një nga tri provimet e detyruara në Maturën Shtetërore. Në këtë provim nxënësit do të zhvillojnë një test të përbashkët për të dyja lëndët: Gjuhë shqipe dhe Letërsi.

Gjuha shqipe dhe Letërsia bëjnë pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Të dyja lëndët synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, ato i aftësojnë nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

### **Gjuha shqipe**

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes.

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të ndryshme, programi krijon mundësi që nxënësit të dallojnë, të analizojnë dhe të vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e këtyre teksteve, por edhe kuptimet dhe mesazhet e tyre.

### **Letërsia**

Letërsia është një nga lëndët kryesore në arsimin e mesëm të lartë. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve. Kjo lëndë, gjithashtu, mundëson krijimin e një raporti pozitiv dhe të qëndrueshëm mes nxënësve dhe letërsisë.

## **Programi orientues**

Programi orientues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe në aftësitë kryesore të mësuara gjatë tri viteve, ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testit përfundimtar të Maturës Shtetërore.

Ky program është bazuar në programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë (AML) dhe përfshin njohuritë dhe shkathhtësisë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

## 2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT ORIENTUES

Programi orientues bazohet në parimin se të zotërosh njohuri dhe aftësi gjuhësore dhe letrare do të thotë të jesh në gjendje t'i demonstrosh ato në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues është mbështetur:

- në programet e lëndës së gjuhës shqipe dhe të lëndës së letërsisë, në AML;
- në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së AML-së;
- në nivelet e arritjes të lëndës së gjuhës shqipe dhe të lëndës së letërsisë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban:

- strukturën e testit;
- peshën e secilës lëndë në test;
- llojet e pyetjeve ose kërkesave që vlerësojnë kompetencat që zotëron nxënësi;
- njohuritë dhe aftësitë e kompetencave gjuhësore dhe letrare.

### 3 PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE GJUHËSORE DHE LETRARE

Duke qenë se provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen me shkrim, kompetencat gjuhësore dhe letrare që vlerësohen janë:

- Të lexuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.
- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër i këtyre kompetencave.

#### 3.1 Gjuhë shqipe

##### **Të lexuarit e teksteve të ndryshme**

Lënda e gjuhës shqipe u krijon mundësi nxënësve që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai, që jo vetëm i kupton dhe i vlerëson njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit njihen me një shumëllojshmëri tekstesh, si dhe zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit. Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

##### **Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**

Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit.

Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, lexues dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Gjatë të shkruarit, nxënësit zbatojnë karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

## **Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit**

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe ato të pikësimit.

### **3.2 Letërsi**

#### **Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare**

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.

#### **Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.**

Nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:

- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;
- të gjinive letrare, të autorëve dhe veprave më përfaqësuese të një periudhe historike ose të një drejtimi letrar.

Mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimi letrar, si dhe të gjinive e të llojeve që lëvrohen.

Letërsia shqipe studiohet paralelisht me letërsinë botërore duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë që letërsia shqipe nuk është një njësi e veçuar dhe e ndarë, por pjesë e pasurisë letrare botërore.



#### 4 PESHA E GJUHËS SHQIPE DHE E LETËRSISË NË TEST

Tabela e mëposhtme paraqet peshën në pikë të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në test. Pikët për shkrimin e esesë janë të përbashkëta për të dyja lëndët

Lëndët	Pesha
<b>Gjuhë shqipe</b>	afërsisht 40 %
Të lexuarit e teksteve të ndryshme (afërsisht 25%)	
Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit (afërsisht 15%)	
<b>Letërsi</b>	afërsisht 40 %
<b>Të shkruarit (ese)</b>	afërsisht 20 %

## 5 STRUKTURA E TESTIT

Testi i gjuhës dhe i letërsisë do të ketë tri pjesë.

<b>Pjesa e parë:</b> Tekst/e jo letrar dhe njohuritë e aftësitë gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.	Teksti jo letrar (përshkrues, rrëfyes, informues paraqitës dhe argumentues) do të jetë i panjohur për nxënësit. Njohuritë dhe aftësitë gramatikore, drejtshkrimore e të pikësimit do të integrohen me tekstin jo letrar.
<b>Pjesa e dytë:</b> Tekst/e letrar	Fragmentet do të jenë nga veprat letrare të përcaktuara në programin orientues.
<b>Pjesa e tretë:</b> Ese	Eseja dëshmon formimin gjuhësor dhe letrar të nxënësit. Tema e esesë mund të lidhet me njërin nga pjesët e mësipërme.

## 6 LLOJET E PYETJEVE/ KËRKESAVE TË REKOMANDUARA

Pyetjet që përdoren në test janë:

- Pyetje me alternativa.
- Pyetje me përgjigje: *E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar.*
- Pyetje me kombinime (me çiftim).
- Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar.
- Etj.

Pyetjet ose kërkesat në test do të jenë të tri niveleve. Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e pikëve në test për secilin nivel.

<b>Niveli bazë</b>	<b>Niveli mesatar</b>	<b>Niveli i lartë</b>
40%	40%	20%

## 7 NJOHURITË DHE AFTËSITË SIPAS KOMPETENCAVE

Për secilën kompetencë janë paraqitur njohuritë dhe aftësitë që duhet të demonstrojë nxënësi.

<b>Kompetenca:</b> Të lexuarit e teksteve të ndryshme	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë</b>
<p><b>Tekste përshkruese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknikat e shkrimit të tekstit përshkrues, si p.sh., përshkrim i një personi real, një personazhi apo personaliteti, një mjedisi, një vendi, një objekti etj.</li> <li>• Karakteristikat strukturore dhe stilistike të tekstit përshkrues.</li> </ul> <p><b>Tekste rrëfyese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknikat e shkrimit të tekstit rrëfyës, si p.sh., rrëfim i një ngjarjeje reale ose një artikull në një gazetë për një ngjarje, kronikë, ditar, autobiografi, biografi etj.</li> <li>• Karakteristikat strukturore dhe stilistike të tekstit rrëfyës.</li> </ul> <p><b>Tekste argumentuese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknikat e shkrimit të tekstit argumentues (një reklamë, një fjalim, një ese etj.).</li> <li>• Karakteristikat strukturore dhe stilistike të teksteve argumentuese.</li> </ul> <p><b>Tekste informuese-paraqitëse</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit informues-paraqitës, si p.sh., minutat e një takimi, një jetëshkrim, një aplikim për punë, një ese etj.</li> </ul>	<p><b>Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor njohuritë paraprake për të kuptuar tekstin;</li> <li>• shfrytëzon elemente, si: titulli, nëntitujt, organizimi i tekstit, fjalori etj., për të kuptuar tekstin;</li> <li>• bën parashikime duke u bazuar tek titulli, nëntitujt, fjalët kyç etj.;</li> <li>• parafrazon informacionin ose idetë e tekstit;</li> <li>• përmbledh idetë (në një ose disa paragrafë);</li> <li>• identifikon qëllimin dhe audiencën (lexuesin) e tekstit;</li> <li>• veçon idenë/idetë kryesore;</li> <li>• dallon në tekste shkakun nga pasoja, faktin nga opinioni, problemin dhe zgjidhjen;</li> <li>• kategorizon dhe klasifikon detajet e dhëna në tekst;</li> <li>• analizon modelet organizative të teksteve: renditje e ideve ose ngjarjeve, krahasim-kontrast, shkak-pasojë etj.;</li> <li>• nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, nga pikëpamjet e autorit etj.;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Karakteristikat strukture dhe stilistike të teksteve informuese-paraqitëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• interpreton dhe integron informacionin e marrë nga një sërë burimesh (harta, grafikë, diagrame etj.);</li> <li>• identifikon dhe analizon elementet pamore (fotografi, ilustrime), të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të ndryshme;</li> <li>• bën përgjithësime në nivel kritik duke përdorur lidhjet brenda dhe jashtë teksteve;</li> <li>• bën lidhje mes një teksti dhe pikëpamjeve ose ideve të tjera jashtë tekstit, si dhe idetë e tekstit i zbaton në një situatë të re;</li> <li>• krahason lloje të ndryshme tekstesh (p.sh., një tekst rrëfyes letrar me një tekst rrëfyes jo letrar), duke u bazuar në kritere të përgjithshme ose në të dhëna specifike;</li> <li>• dallon dhe krahason elemente të stilit në një shumëllojshmëri tekstesh;</li> <li>• identifikon karakteristika të strukturës të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti, evidenca, indeksi, fjalorthi, tabela e përmbajtjes etj.;</li> <li>• identifikon karakteristika përmbajtësore të teksteve, si: tema, tematika, motivi etj.;</li> <li>• analizon veçoritë gjuhësore të një teksti;</li> <li>• analizon dhe vlerëson përdorimin e referencave të besueshme brenda një teksti;</li> <li>• tregon se zgjedhja e fjalëve kyç ndikon në shtjellimin e temës ose në arritjen e qëllimit të saj;</li> <li>• dallon vërtetësinë dhe koherencën e</li> </ul>
---	--

	<p>argumenteve në tekste të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe ndaj lexuesit, të cilit i drejtohet;</li> <li>• përdor informacione nga burime të ndryshme për një çështje të caktuar, për të ndërtuar një argument dhe për të nxjerrë përfundime;</li> <li>• demonstroi se si stili i autorit mund të ndikojë te lexuesi nëpërmjet zgjedhjes së fjalëve, teknikave të shkrimit, përdorimit të gjuhës së figurshme etj.</li> </ul> <p><b>Llojet e teksteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve jo letrare, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ teksti përshkrues,</li> <li>○ teksti rrëfyes,</li> <li>○ teksti argumentues,</li> <li>○ teksti informues-paraqitës.</li> </ul> </li> </ul> <p><b>Pasurimi i fjalorit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia;</li> <li>• shfrytëzon përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme;</li> <li>• dallon kuptimin e drejtpërdrejtë nga i nënkuptuari për të vlerësuar forcën e fjalës.</li> </ul>
--	---

<b>Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese përshkruese.</li> <li>• Ese rrëfyese.</li> <li>• Ese argumentuese.</li> </ul>	<p><b>Shkrimi si proces</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikon duke identifikuar qëllimin, lexuesin dhe kontekstin;</li> <li>• krijon ose mbledh ide të përshtatshme për punët me shkrim duke përdorur strategji të ndryshme, si: shkrimi i lirë, stuhi mendimi, hartë koncepti, kllaster etj.;</li> <li>• rishikon esenë për të përmirësuar strukturën, qartësinë dhe për të arritur saktësi në shprehjen e kuptimit;</li> <li>• identifikon elementet e gjuhës dhe të përmbajtjes (fakte, ide, detaje etj.), të cilat janë të përshtatshme për lexuesin dhe kontekstin, dhe i zëvendëson, shton, fshin ose riorganizon fjalë, fraza, fjali, fakte, ide, detaje përshkruese, emocionale etj.;</li> <li>• përmirëson renditjen e fakteve, ideve dhe detajeve brenda ose në mes të paragrafëve;</li> <li>• korrigjon gabimet gjuhësore (gramatikë, drejtshkrim, pikësim).</li> </ul> <p><b>Shkrimi si produkt</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• organizon fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin, lexuesin dhe llojin e tekstit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje, fakte dhe shembuj të përshtatshëm për qëllimin, lexuesin, kontekstin etj.;</li> <li>• i përmbahet temës së esesë;</li> <li>• shkruan ese koherente;</li> <li>• përdor një fjali të temës për të futur idenë kryesore në një paragraf;</li> <li>• përpunon dhe shtjellon idenë kryesore të një paragrafi duke përdorur shembuj, detaje, fakte, përshkrime etj.;</li> <li>• rimerr idenë kryesore në paragrafin përmbyllës të tekstit dhe shkruan mbylljen e tij;</li> <li>• përdor strategji mbështetëse (anekdota personale, mbështetje të besimet e përbashkëta, opinione ekspertësh) në mënyrë që të bindë lexuesin;</li> <li>• ka stil dhe origjinalitet në ese.</li> </ul> <p><b>Llojet e teksteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkruan ese përshkruese me tema të ndryshme;</li> <li>• shkruan ese rrëfyese me tema të ndryshme;</li> <li>• shkruan ese argumentuese me tema të ndryshme.</li> </ul>
--	---



**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Njohuritë**

**Morfologji**

**Klasat e fjalëve**, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

**Emri**

- Emrat që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës.
- Emrat që e formojnë shumësin me prapashtesa, si: -ë, -nj, -ër, -inj, -ra ose me ndërrime tingujsh.

**Folja**

- Foljet kalimtare dhe jokalistare.
- Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprare dhe joveprare e foljeve të parregullta.

**Aftësitë**

**Morfologji**

Nxënësi:

- përcakton klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij;
- klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe në të pandryshueshme;
- dallon emrat e gjinisë mashkullore që e ndryshojnë gjininë, kur kalojnë në numrin shumës;
- përcakton prapashtesën me të cilën e formojnë numrin shumës, disa emra mashkulorë, si:
  - prapashtesën -e (shtigje, male, vende, mendime, personazhe, insekte etj.);
  - prapashtesën -ra (djathëra, vajra, mallra, ujëra, shira etj.);
- përdor drejt emrat që në numrin shumës marrin prapashtesat ë, -nj, -ër, -inj, -ra ose ndërrojnë tingujt si p.sh.: dibranë, drejtorë, arsimtarë, floriinj priftërinj, prindër, erëra, brigje, kapituj etj.;
- dallon dhe krahason foljet kalimtare dhe jokalistare;
- ndërton fjali me folje kalimtare dhe jokalistare;
- zgjedhon foljet e parregullta (jam, them, rri, dua etj.) në kohët e mënyrës dëftore dhe habitore, në formën veprare dhe joveprare;

<p><b>Mbiemri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumësi i mbiemrave. Përdorimi në shumës i mbiemrave që përcaktojnë emra mashkullorë me shumësin me - e, - ra dhe me -a.</li> </ul> <p><b>Përemri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e përemrave, sipas kuptimit që kanë dhe funksionit që kryejnë (vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar). Kategoritë e tyre gramatikore.</li> </ul> <p><b>Ndajfolja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e ndajfoljeve. Dallimi i ndajfoljeve nga parafjalët me të njëjtën formë.</li> <li>• Shkallët e ndajfoljeve.</li> </ul> <p><b>Lidhëza</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhëzat bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vendos në trajtën e duhur mbiemrat ose fjalët e tjera përcaktuese pas emrave që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës si p.sh.: mendime të zymta, personazhe interesante, vende malore, ujëra të rrëmbyeshme, djathëra të kripura etj.;</li> <li>• dallon dhe përdor në fjali, lloje të ndryshme përemrash;</li> <li>• përcakton kategoritë gramatikore të përemrave;</li> <li>• lakon përemrat vetorë;</li> <li>• dallon ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre;</li> <li>• përcakton shkallën e ndajfoljes;</li> <li>• dallon ndajfoljen nga parafjalët me të njëjtën formë;</li> <li>• përcakton llojin e lidhëzave bashkërenditëse dhe lidhëzave nënrenditëse;</li> <li>• përdor drejt në fjali lidhëzat.</li> </ul>
<p><b>Sintaksë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjymtyrët e dyta.</li> <li>• Kundrinori, llojet (kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë me ose pa</li> </ul>	<p><b>Sintaksë</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton gjymtyrët e dyta në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij;</li> </ul>

<p>parafjalë).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrethanori, llojet (rrethanori i vendit, i kohës, i shkakut, i qëllimit, i mënyrës etj.).</li> <li>• Përcaktori, llojet (përcaktori me përshtatje, përcaktori me drejtim, përcaktori me bashkim, ndajshtimi).</li> <li>• Gjymtyrët homogjene.</li> <li>• Fjalitë e thjeshtë dhe fjalitë e përbërë.</li> <li>• Fjalitë e përbërë me bashkërenditje dhe fjalitë e përbërë me nënrenditje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon kundrinorin dhe përcakton llojin e tij;</li> <li>• tregon se me çfarë është shprehur kundrinori;</li> <li>• ndërton fjali me kundrinorë të llojeve të ndryshme;</li> <li>• dallon rrethanorin dhe përcakton llojin e tij;</li> <li>• përcakton se me çfarë është shprehur rrethanori;</li> <li>• ndërton fjali me rrethanorë të llojeve të ndryshme;</li> <li>• dallon përcaktorin dhe përcakton llojin e tij;</li> <li>• tregon se me çfarë është shprehur përcaktori;</li> <li>• formon fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme;</li> <li>• krahason përcaktorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë;</li> <li>• dallon gjymtyrët homogjene në fjali;</li> <li>• përcakton tiparet e fjalisë së thjeshtë dhe ato të fjalisë së përbërë;</li> <li>• analizon tiparet e përbashkëta dhe tiparet të veçanta mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë;</li> <li>• dallon marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbërë;</li> <li>• dallon llojin e fjalive me bashkërenditje;</li> <li>• ndërton fjali të përbëra me bashkërenditje këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse dhe shkakore-motivuese;</li> </ul>
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje;</li> <li>• ndërton fjali të përbëra me nënrenditje;</li> <li>• analizon fjalitë e përbëra me shumë pjesë;</li> <li>• ndërton një fjali të përbërë në bazë të një skeme të dhënë;</li> <li>• përshtat në kohë dhe në mënyrë foljet (kallëzuesit) në pjesët e fjalisë së përbërë;</li> <li>• përdor drejt shenjat e pikësimit të fjalitë e përbëra.</li> </ul>
<p><b>Leksikologji</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjërimet në gjuhën shqipe (ligjërimi i thjeshtë, ligjërimi bisedor dhe ligjërimi libror).</li> <li>• Stilet funksionale në gjuhën shqipe: stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik- administrativ.</li> </ul>	<p><b>Leksikologji</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe;</li> <li>• analizon tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit bisedor dhe të ligjërimit libror;</li> <li>• krahason ligjërimin bisedor me ligjërimin e thjeshtë;</li> <li>• dallon llojin e ligjërimit në një tekst;</li> <li>• ndërton tekste të shkurtra të cilat kanë tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit libror ose të ligjërimit libror;</li> <li>• përcakton kuptimin e termit “stil funksional”;</li> <li>• përcakton se cilit stil i përket një tekst;</li> <li>• analizon elementet kryesore të secilit stil;</li> <li>• krahason stilet me njëri-tjetrin;</li> <li>• harton tekste të shkurtra që u përkasin stileve të ndryshme (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik-</li> </ul>

	administrativ).
<p><b>Drejtshkrim dhe pikësim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i shenjave të pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat, tri pikat, thonjëzat).</li> <li>• Përdorimi i presjes të fjalitë e përbëra dhe të fjalitë e ndërmjetme, si dhe i shenjave të tjera të pikësimit të fjalitë e ndërkalura.</li> </ul>	<p><b>Drejtshkrim dhe pikësim</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkruan dhe përdor drejt shenjat e pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat);</li> <li>• përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat dhe thonjëzat);</li> <li>• përdor drejt presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkalura.</li> </ul>

<b>Kompetenca:</b> Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë<sup>1</sup></b>
<p><b>Letërsia dhe gjinitë letrare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Karakteri historik i gjinive letrare.</li> <li>• Veçoritë e llojeve të gjinisë epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani.</li> <li>• Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne etj.</li> <li>• Veçoritë e llojeve të gjinisë dramatike, si: tragjedia, komedia, drama.</li> </ul> <p><b>Figurat stilistike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Figurat e kuptimit: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi</li> </ul>	<p><b>Elementet e tekstit letrar</b></p> <p><b>a) Fabula dhe subjekti</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• rrëfen dhe analizon subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;</li> <li>• përcakton dhe analizon fabulën e një teksti;</li> <li>• bën dallimin mes fabulës dhe subjektit;</li> <li>• analizon ngjarjet kryesore të një teksti;</li> <li>• dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe</li> </ul>

<sup>1</sup> Veprat për të cilat nxënësit do të demonstrojnë këto njohuri dhe aftësi janë dhënë më poshtë.

<p>figurativ.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Figurat e shqiptimit poetik: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofa, aliteracioni.</li> <li>• Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve: metafora, alegoria.</li> <li>• Figurat e sintaksës poetike: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi.</li> </ul> <p><b>Elementet e tekstit letrar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fabula dhe subjekti.</li> <li>• Tema dhe motivet.</li> <li>• Rrëfimtari, autori dhe lexuesi.</li> <li>• Format e rrëfimit.</li> <li>• Sistemi i personazheve. Marrëdhëniet kryesore mes personazheve.</li> <li>• Mjedisi, koha dhe atmosfera.</li> <li>• Stili. Gjuha e një vepre letrare.</li> <li>• Ritmi dhe vargu (edhe vargu i lirë). Rima dhe llojet e saj.</li> <li>• Strofa, funksioni dhe llojet e saj.</li> </ul>	<p>rëndësinë e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon konfliktin/konfliktet dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;</li> <li>• analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;</li> <li>• përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori.</li> </ul> <p><b>b) Personazhet</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe në mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;</li> <li>• evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);</li> <li>• analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;</li> <li>• dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë);</li> <li>• shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;</li> <li>• analizon marrëdhëniet njerëzore dhe sjelljet e njeriut përmes studimit të personazheve.</li> </ul> <p><b>c) Mjedisi, koha dhe atmosfera</b></p> <p>Nxënësi:</p>
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;</li> <li>• veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;</li> <li>• përshkruan ndikimin e tij emocional dhe psikologjik nga leximi i një vepre letrare;</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.</li> </ul> <p><b>d) Tematika</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon temën dhe motivet e një teksti;</li> <li>• analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;</li> <li>• demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.</li> </ul> <p><b>e) Stili dhe gjuha</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;</li> <li>• dallon, analizon dhe vlerëson gjuhën e figurshme;</li> <li>• vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti.</li> </ul> <p><b>Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror</b></p>
--	--

	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;</li> <li>• shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.</li> </ul> <p><b>Lidhja mes tekstit dhe lexuesit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;</li> <li>• tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul> <p><b>Reflektimi ndaj tekstit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.</li> </ul> <p><b>Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> </ul>
--	---



Veprat letrare të mëposhtme duhen punuar me nxënësit. Hartuesit e testit do ta ndërtojnë pjesën e testit të letërsisë duke iu referuar kësaj liste.

<b>Kompetenca:</b> Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë</b>
<p><b>Cikli i Kreshnikëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cikli i Kreshnikëve, si pjesa më e rëndësishme e epikës shqiptare.</li> <li>• Rëndësia e Ciklit të Kreshnikëve për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve.</li> <li>• Vlerat artistike të Ciklit të Kreshnikëve.</li> </ul>	<p><b>Cikli i Kreshnikëve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rëndësinë e Ciklit të Kreshnikëve për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore të shqiptarëve;</li> <li>• interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të Ciklit të Kreshnikëve.</li> </ul>
<p><b>Homeri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Iliada.</li> <li>• Rëndësia e Homerit në letërsinë e mëvonshme.</li> </ul>	<p><b>Homeri “Iliada”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rëndësinë e Homerit në letërsinë e mëvonshme;</li> <li>• interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të poemës “Iliada”</li> </ul>
<p><b>Aligeri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ferri.</li> <li>• Rëndësia e kësaj vepre.</li> </ul>	<p><b>Dante Aligeri “Ferri”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të Ferrit;</li> <li>• analizon vlerat, strukturën, filozofinë dhe rëndësinë e “Ferrit”.</li> </ul>
<p><b>Shekspir</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hamleti.</li> <li>• Rëndësia e Shekspirit në letërsinë botërore.</li> </ul>	<p><b>Shekspir “Hamleti”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të veprës “Hamleti”;</li> <li>• diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Shekspirit në letërsinë botërore.</li> </ul>

<p><b>Hygo</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Katedralja e Parisit.</li> <li>• Hygoi si prijës i romantizmit.</li> </ul>	<p><b>Hygo “Katedralja e Parisit”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rolin e Hygoit në letërsinë romantike dhe në letërsinë e mëvonshme franceze;</li> <li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Katedralja e Parisit”.</li> </ul>
<p><b>N. Frashëri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lulet e verës.</li> <li>• Naim Frashëri, figura më përfaqësuese e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kontributi i tij në çështjen kombëtare, si dhe në gjuhën e në letërsinë shqipe.</li> </ul>	<p><b>N. Frashëri “Lulet e verës”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson kontributin e Naim Frashërit në çështjen kombëtare dhe në lëvrimin e gjuhës shqipe;</li> <li>• identifikon veprat letrare të Naim Frashërit;</li> <li>• dallon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e Naim Frashërit;</li> <li>• interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të vëllimit poetik “Lulet e verës”.</li> </ul>
<p><b>Franc Kafka</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metamorfoza</li> <li>• Faktorët objektivë historikë që ndikuan në veprën e Kafkës.</li> <li>• Qëndrimi i Kafkës ndaj vetmisë, zhgënjimit, tjetërsimit njerëzor, vdekjes.</li> <li>• Veçoritë kryesore të krijimtarisë së Kafkës. Stili i Kafkës.</li> </ul>	<p><b>Franc Kafka “Metamorfoza”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon faktorët objektivë historikë që ndikuan në veprën e Kafkës;</li> <li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson novelën “Metamorfoza”.</li> </ul>

<p><b>Lasgush Poradeci</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ylli i zemrës,</li> <li>• Poeti modern i shqipes.</li> <li>• Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit.</li> <li>• Mbështetja në trashëgiminë poetike të Naimit dhe në letërsinë moderne të Europës.</li> </ul>	<p><b>Lasgush Poradeci “Ylli i zemrës”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon risitë dhe origjinalitetin që solli Poradeci në poezinë shqipe;</li> <li>• analizon motivet kryesore të poezisë së Poradecit;</li> <li>• veçon dhe gjykon ndikimet që pati Poradeci nga krijimtaria e Naim Frashërit dhe nga poezia moderne e Evropës;</li> <li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Ylli i zemrës”.</li> </ul>
<p><b>Migjeni</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Novelat e qytetit të veriut.</li> <li>• Vargjet e lira.</li> <li>• Fryma e re që solli Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shkëputja nga tradita, temat e ndaluara, vargu i lirë, shembja e kulteve politike, fetare etj.</li> <li>• Njeriu në letërsinë e Migjenit (jeta në situata ekzistenciale).</li> </ul>	<p><b>Migjeni “Novelat e qytetit të veriut” dhe “Vargjet e lira”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson frymën e re që sjell Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shkëputjen nga letërsia pararendëse, trajtimin e temave tabu, vargun e lirë etj.;</li> <li>• portretizon njeriun në krijimtarinë e Migjenit, duke e krahasuar edhe me krijimtarinë e letërsisë së mëparshme, por edhe me letërsinë e kohës së tij;</li> <li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin në prozë “Novelat e qytetit të veriut”;</li> <li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Vargjet e lira”.</li> </ul>
<p><b>Ismail Kadare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pallati i ëndrrave.</li> <li>• Vendi që zë Kadare në letërsinë shqipe.</li> <li>• Bota shqiptare në veprën e Kadaresë.</li> </ul>	<p><b>Ismail Kadare “Pallati i ëndrrave”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsinë shqipe;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"><li>• interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Pallati i ëndrrave”.</li></ul>
--	--